

## **SHQIPËRIA: Grupi 2**

Qeveria e Shqipërisë nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit; megjithatë, është duke bërë përpjekje domethënëse për ta arritur këtë. Qeveria demonstroi përpjekje në rritje krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit; për pasojë, Shqipëria mbeti në Grupin 2. Këto përpjekje përfshinë përditësimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) për identifikimin dhe referimin e viktimave, alokimin e fondeve për koordinatorët e viktimave në çdo prokurori duke filluar nga viti 2019 dhe institucionalizimin e trajnimit për trafikimin brenda Policisë Kufitare dhe Migracionit (PKM). Gjithashtu, Qeveria dyfishoi buxhetin për Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafikim (ZKKA) dhe miratoi planin kombëtar të veprimit për vitet 2018-2020. Megjithatë, qeveria nuk përmbushi standardet minimale në një numër fushash kyçe. Qeveria vazhdoi të hetojë, të ndjekë penalisht dhe të dënojë më pak raste, duke çuar në nivelin më të ulët të veprimeve të raportuara ligj-zbatuese në katër vite. Përveç kësaj, qeverisë i munguan përpjekjet të identifikimit dhe ligjzbatimit proaktiv, në veçanti, nuk mori pjesë në mënyrë të vazhdueshme në njësitë e lëvizshme të identifikimit të viktimave apo nuk kontrolloi në mënyrë të vazhdueshme popullatat e cënueshme. Qeveria vazhdoi të vononte financimin për strehëzat e OJF-ve dhe nuk aplikoi qasje konsistente të fokusuara tek viktima gjatë hetimeve dhe ndjekjeve penale.

### **REKOMANDIME ME PËRPARËSI:**

Në mënyrë energjike të hetojë, ndjekë penalisht dhe dënojë trafikantët - përfshi zyrtarë e implikuar - sipas neneve 110(a) dhe 128(b) të kodit penal. •Të institucionalizohet dhe të vazhdohet trajnimi i zyrtarëve ligj-zbatues, prokurorëve dhe oficerëve gjyqësorë, sidomos prokurorëve të rretheve, mbi hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të trafikimit, përfshi udhëzime mbi elemente të mbivendosjes së prostitucionit dhe trafikimit. •Të rriten përpjekjet për të kontrolluar popullatat e cënueshme dhe të trajnojë policë, inspektorë të punës dhe zyrtarë të tjerë të vijës së parë mbi identifikimin proaktiv të viktimave. •Të krijohen mekanizma financimi që alokojnë financime dhe burime të mjaftueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt për strehëzat e administruara nga qeveria dhe strehëzat e administruara nga OJF-të për viktima të trafikimit. •Të zgjerohet juridiksioni i inspektorëve të punës për të inspektuar biznese që nuk janë të

regjistruara ligjërisht. •Të përmirësohet qëndrueshmëria dhe pjesëmarrja e ligjzbatuesve në njësitë e lëvizshme të identifikimit të viktimave të trafikimit. •Të rriten shërbimet e riintegrit, përfshirë akses në arsim për fëmijët viktima. •Të zbatohen qasje me viktimën në qendër dhe masa mbrojtëse për dëshmitarët viktima, gjatë seancave gjyqësore.

## **NDJEKJA PENALE**

Qeveria uli përpjekjet e ligjzbatimit. Nenet 110(a) dhe 128(b) të kodit penal kriminalizonin trafikimin për qëllime seksi dhe pune dhe parashikonin dënime prej tetë deri 15 vjet burgim për një veprë penale të trafikimit që përfshin një viktimë të rritur dhe dhjetë deri në 20 vjet burgim për një veprë penale që përfshin një viktimë të mitur. Këto dënime ishin mjaftueshëm shtrenguese dhe, për sa i përket trafikimit për qëllime seksuale, në përpjesëtim me ato të parashikuara për të tjera krime të rënda, të tilla si përdhunimi. Policia e shtetit shqiptar (PSH) hetoi 38 raste trafikimi me 51 të dyshuar (69 raste me 80 të dyshuar në vitin 2017); nëntë nga këta të dyshuar u hetuan për trafikim të fëmijëve (22 në vitin 2017) dhe 42 për trafikim të rriturish (58 në vitin 2017). PSH gjithashtu hetoi tre të dyshuar që me vetëdije nxitën apo kërkuan një viktimë të trafikimit seksual të kryejë një akt seksual me pagesë (asnjë në vitin 2017). Zyra e Prokurorit të Krimeve të Rënda (ZPKR) ndoqi penalisht dy raste me gjashtë të pandehur (pesë raste me pesë të pandehur në vitin 2017); tre nga këta të pandehur u ndoqën penalisht për trafikim të fëmijëve (dy në vitin 2017) dhe tre për trafikim të të rriturve (tre në vitin 2017). Gjykatat dënuan pesë trafikantë (shtatë në vitin 2017); katër për trafikim të fëmijëve (një në vitin 2018) dhe një për trafikim të rriturish (gjashtë në vitin 2017). Të gjithë trafikantët e dënuar morën dënime me burg; një trafikant u dënua me dy vjet dhe tetë muaj për trafikim të të rriturve dhe katër trafikantë u dënuan midis gjashtë vjet dhe tetë muaj deri në tetëmbëdhjetë vjet për trafikim të fëmijëve. Gjykata e apelit shqyrtoi dhe la në fuqi vendimet për pesë trafikantë.

PSH mbajti një Njësi Anti-Trafikim, e cila ka hetuar trafikimin e personave përveç trafikimit të drogës dhe kontrabandës. Qeveria vijoi me reformat gjyqësore që përfundimisht do të ndryshojnë juridikisionin gjyqësor për rastet e trafikimit, përfshirë kalimin e çështjeve që nuk lidhen me krimin e organizuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda tek ato të rretheve. Megjithatë, ZPKR raportoi se prokurorët e

rretheve nuk kishin përvojën dhe kapacitetin për të ndjekur penalisht sa e si duhet çështjet e trafikimit. Autoritetet raportuan konfuzion midis elementëve mbivendosës të shfrytëzimit të prostitucionit dhe trafikimit dhe hera-herës, aplikuan akuzën më të lehtë sepse kërkonte më pak specializim dhe kohë ose për shkak të besimit të gabuar se krimet e trafikimit kërkonin një element ndërkombëtar. Burimet e kufizuara dhe ndryshimet e vazhdueshme brenda organeve ligjzbatuese krijuan pengesa shtesë në ruajtjen e kapaciteteve për të hetuar trafikimin. OJF-të raportuan përmirësimin e bashkëpunimit me organet ligjzbatuese dhe prokurorët. PKM institucionalizoi trajnimin anti-trafikim dhe qeveria, hera-herës, në bashkëpunim me shoqërinë civile, trajnua 59 oficerë policie, 53 gjyqtarë, 119 prokurorë rrethi dhe tre inspektorë të Gjykatës së Lartë. Qeveria nuk raportoi ndonjë hetim, ndjekje penale apo dënim të punonjësve qeveritarë të implikuar në vepra penale trafikimi; megjithatë, implikimi zyrtar dhe korrupsioni ishin shqetësime domethënëse. PSH arrestoi 20 të dyshuar si trafikantë të shfrytëzimit seksual për llogari të autoriteteve italiane dhe greke. Qeveria nënshkroi një marrëveshje mirëkuptimi me prokurorë bullgarë dhe ekstradoi tre të dyshuar, secilin respektivisht në Greqi, Kosovë dhe Hungari.

## **MBROJTJA**

Qeveria vazhdoi përpjekjet për mbrojtjen e viktimave. Qeveria dhe OJF-të identifikuan 95 viktima trafikimi dhe viktima të mundshme të trafikimit (105 në vitin 2017). Nga këto, 28 ishin të rritur dhe 67 ishin fëmijë (49 të rritur dhe 56 fëmijë në vitin 2017), 60 ishin femra dhe 35 meshkuj (80 femra dhe 25 meshkuj në vitin 2017) dhe një ishte e huaj (nëntë viktima të huaja në vitin 2017). Autoritetet identifikuan 93 persona si viktima të mundshme dhe dy u identifikuan zyrtarisht si viktima (79 viktima të mundshme dhe 26 të identifikuar zyrtarisht si viktima në vitin 2017). Qeveria nuk mundi të japë detaje mbi llojin e shfrytëzimit për të gjitha viktimat, si zyrtarisht edhe të mundshme, por të paktën 36 iu nënshtruan trafikimit seksual, 25 punës së detyruar dhe 27 lypjes së detyruar. Qeveria mbajti një mekanizëm kombëtar referimi shumëdisiplinor dhe përditësoi PSV-të për identifikimin dhe referimin e viktimave të shërbimet. Personat në vijën e parë referuan viktimat e mundshme të trafikimit tek organet ligjzbatuese dhe shërbimet sociale shtetërore që kryen intervista të përbashkëta për të përcaktuar statusin zyrtar të viktimës. Ligji ofronte shërbime të barabarta si për viktimat e mundshme

ashtu edhe për viktimat e njohura zyrtarisht. OJF-të identifikuan pjesën më të madhe të viktimave; qeveria identifikoi vetëm 33 nga 95 viktima dhe viktima të mundshme trafikimi (60 në vitin 2017), përfshirë vetëm pesë të identifikuar nga organet ligjzbatuese (11 në vitin 2017). OJF-të, me mbështetjen e qeverisë, mbajtën njësitë e lëvizshme të identifikimit të viktimave të përbëra nga punonjës socialë dhe policë në tre qarqe, por qëndrueshmëria e njësive ishte e pasigurt për shkak të mungesës së personelit të përhershëm, institucionalizimit dhe burimeve. Njësitë e lëvizshme të identifikimit të viktimave identifikuan 51 viktima të mundshme (26 në vitin 2017). Ekspertët raportuan se policia nuk mori pjesë në mënyrë qëndrueshme në njësitë e lëvizshme të identifikimit të viktimave, pavarësisht nga nënshkrimi i një marrëveshjeje mirëkuptimi që formalizoi pjesëmarrjen e tyre në to. Ligjzbatuesit rallëherë filluan çështje kur shoqëria civile identifikoi një viktimë të mundshme, por PSH vërejti dallime me shoqërinë civile në përkufizim të asaj ç'ka përbën trafikim, gjë që shkaktoi pengesa në identifikim. PKM përditësoi PSV-të e brendshme për identifikimin dhe hartoi kërkesa të raportimit ditor për viktimat e trafikimit; megjithatë, PKM nuk mundi të monitorojë në mënyrë konsekuente migrantët për shkak të rritjes së flukseve migratore dhe mungesës së oficerëve dhe përkthyesve të PKM. Vëzhguesit vazhduan të raportonin se policia nuk kontrollonte në mënyrë konsekuente individët për përfshirje të mundshme në prostitucion gjatë kontrolleve të befasishme dhe hetimeve për lokale që përdoren për prostitucion dhe Inspektorati i Punës nuk kishte trajnimin e duhur për të identifikuar vikimat e punës së detyruar. Po kështu, përpjekjet e identifikimit për lypjen e detyruar mbetën të pamjaftueshme, sidomos mes fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve të rrugës, dhe fëmijëve që lëviznin mes kufijve për të lypur.

Qeveria administronte një strehëz të specializuar dhe mbështeste tri strehëza të specializuara që administroheshin nga OJF-të. Qeveria akordoi 21.6 milionë *lekë* (\$201,770) për strehëzat e administruara nga OJF-të për të mbështetur 29 paga personeli, krahasuar me 20.2 milionë *lekë* (\$188,700) për të mbështetur 29 paga personeli në vitin 2017. Qeveria ofroi një shtesë prej 5.2 milionë *lekë* (\$48,580) për mbështetje ushqimore për strehëzat e administruara nga OJF-të, krahasuar me 5.5 milionë *lekë* (\$51,380) në vitin 2017. Qeveria akordoi 22.5 milionë *lekë* (\$210,180) për strehëzën e administruar nga qeveria, krahasuar me 22.2 milionë *lekë* (\$207,380) në vitin 2017. Qeveria nuk transferoi burime tek një fond i aseteve

kriminale të konfiskuara për të financuar shërbime mbështetëse, krahasuar me 4.7 milionë *lekë* (\$43,900) në vitin 2017. Financimi për strehëzat e administruara nga OJF-të është rritur vazhdimisht gjatë katër viteve të fundit; megjithatë, vonesat e vazhdueshme të financimit penguan funksionimin e strehëzës dhe qeveria decentralizoi mekanizmat e financimit për të gjitha programet sociale të qeveritë lokale, duke filluar nga viti 2019. Grantet bashkiake u dhanë përparësi OJF-ve që ofronin asistencë në nivel vendor në vend të sferës kombëtare të nevojshme për strehëzat e trafikimit, dhe ekspertët pretendonin se kërkesat dhe procedurat e ofertimit në nivel bashkiak qenë të mbushura me nepotizëm dhe korrupsion. Strehëzat e administruara nga OJF-të operonin nën kufizime financiare dhe mbështeteshin të burimet e jashtme për kostot e funksionimit. Katër strehëzat përbënin Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Anti-trafikim (KKSAT) dhe viktimat që kërkonin shërbime, që nuk ishin në dispozicion tek njëra qendër referoheshin tek një qendër tjetër, brenda koalicionit. KKSAT dhe qeveria ofruan asistencë për 78 viktima dhe viktima të mundshme (101 në vitin 2017), përfshi ushqim, këshillim për kujdesin mendor, ndihmë ligjore, kujdes mjekësor, shërbime arsimore, shërbime punësimi, asistencë për fëmijët e viktimave, mbështetje financiare, strehim afatgjatë, veprimtari shoqërore, trajnim profesional, si dhe ndjekje pas riintegrit. Zyrtarë të Punësimin bashkëpunuan me bizneset private dhe OJF-të për të siguruar qasje në trajnime dhe punësim për viktimat e trafikimit. Qeveria ofronte kujdes shëndetësor falas, por aksesin në arsim për viktimat fëmijë ishte i pamjaftueshëm. Për shembull, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka miratuar fonde për strehëzën e administruar nga qeveria për të punësuar një mësues me kohë të pjesshme për viktimat, që nuk mund të shkojnë në shkollë. Po ashtu, qeveria siguroi tekste shkollore falas për fëmijët në “vështirësi ekonomike e sociale”, që nuk përfshinin në mënyrë të qartë viktimat e trafikimit dhe disa drejtori rajonale të Ministrisë së Arsimit e përdorën këtë mungesë për të përjashtuar fëmijët viktima, nga marrja e teksteve falas. Strehëzat e administruara nga OJF-të lejonin viktimat e rritura të largoheshin vullnetarisht nga strehëza, por ajo e administruar nga shteti kërkonte që viktimat të njoftonin drejtorin e qendrës për vendndodhjen e tyre në mënyrë që të ndihmonte në mbrojtjen e tyre. Një qendër e administruar nga OJF ofronte shërbime të specializuara për viktimat fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe viktimave meshkuj iu ofroheshin apartamente me qera, ku merrnin asistencë nga OJF-të. Vëzhguesit raportuan se strehëzat e KKSAT kishin staf profesional dhe cilësi të mirë të

kujdesit. Ekspertët raportuan se personat në vijën e parë shpesh referonin individë që nuk ishin viktime të trafikimit në strehën e administruar nga qeveria, përfshi individë me probleme të shëndetit mendor, migrantë apo viktime të krimeve të tjera. Viktimat e huaja kishin akses në të njëjtat shërbime si viktimat vendase dhe ligji ofronte për viktimat e huaja një periudhë tre-mujore reflektimi me status të përkohshëm rezidence dhe autorizim për të punuar deri në dy vjet. Qeveria akordoi ose rinovoi leje qëndrimi për shtatë viktime të huaja (gjashtë në vitin 2017).

Ndryshe nga disa vite të mëparshme, qeveria nuk i penalizoi me dashje viktimat, por mund të ketë penalizuar disa viktime të trafikimit, për shkak të përpjekjeve të pamjaftueshme të identifikimit. Pesë viktime bashkëpunuan me agjencitë ligjzbatuese në hetime dhe ndjekje penale (23 në vitin 2017); megjithatë, qeveria nuk aplikoi me konsekuencë hetime dhe ndjekje penale duke patur viktimat në qendër. Ligjzbatimi nuk ofronte siguri dhe mbështetje të mjaftueshme konsekuente dhe viktimat e familjet e tyre merrnin kërcënime gjatë procesit gjyqësor. ZKPR zotëronte pajisje që lejonin dëshmi me anë të videokonferencave, që u përdor në një rast. Viktimat që dëshmonin kundër trafikantëve kishin akses në programin për mbrojtjen e dëshmitarit; asnjë viktimë trafikimi nuk u përfshi në program (një në vitin 2017). Policia vendore ka përmirësuar zbatimin e procedurave specifike për fëmijët, duke përfshirë në mënyrë konsekuente përfshirjen e punonjësve socialë dhe psikologëve gjatë marrjes së deklaratave zyrtare nga fëmijët. Qeveria nxorri legjislacionin zbatues për ofrimin e ndihmës juridike falas dhe financoi koordinatorë për viktimat në çdo prokurori, duke filluar nga viti 2019; zyrat e prokurorisë punësuan pesë koordinatorë për viktimat. Viktimat mund të merrnin dëmshpërblim nga qeveria ose të ngrinin padi civile kundër trafikantëve; asnjë viktimë nuk kishte marrë ndonjëherë dëmshpërblim. Ligji ofronte asistencë për riatdhesim për qytetarët shqiptarë të identifikuar jashtë; autoritet ndihmuan në riatdhesimin vullnetar të tre viktimave shqiptare nga Gjermania, Portugalia dhe Mbretëria e Bashkuar (katër në vitin 2017). Qeveria riatdhesoi gjithashtu viktime të huaja, përfshi një nga Kosova dhe një nga Maqedonia e Veriut.

## **PARANDALIMI**

Qeveria rriti përpjekjet për parandalimin e trafikimit. Qeveria miratoi planin kombëtar për veprim për vitet 2018-2020 dhe caktoi për zbatimin e tij 448.9

milionë *lekë* (\$4.57 milionë). Qeveria caktoi për Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim (ZKKA) 11.9 milionë *lekë* (\$111,160), krahasuar me 5.7 milionë *lekë* (\$53,250) në 2016 dhe 2017. Vëzhguesit raportuan se ZKKA bashkërendoi përpjekjet kundër trafikimit, por u përball me sfida të brendshme dhe të jashtme. Qeveria mbajti një grup punues shumëdisiplinor dhe një task forcë të veçantë për zhvillimin dhe vëzhgimin e politikave antitrafikim. Dymbëdhjetë komitete rajonale anti-trafikim përbërë nga zyrtarë vendorë dhe OJF, punuan për parandalim dhe ndihmën për viktimat. ZKKA nuk ka publikuar rregullisht raporte për veprimtarinë në faqen e internetit që prej vitit 2017, por organizoi katër mbledhje me aktorët e përfshirë në mekanizmin kombëtar të referimit (MKR). Vëzhguesit raportuan se prokurorët merrnin pjesë rallë në takimet e MKR. ZKKA, në bashkëpunim me shoqërinë civile, zhvilloi fushata ndërgjegjësimi për studentët, mësuesit dhe publikun e gjerë. ZKKA mbajti edhe takime informuese me përfaqësues nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Qeveria nuk bëri përpjekje për të rregulluar apo ndëshkuar punëdhënësit për praktika të paligjshme, të cilat rrisin mundësinë e shfrytëzimit të migrantëve jashtë vendit. Inspektorët e punës nuk kishin autoritetin për të inspektuar aktivitetet informale të punës, përfshirë dhe bizneset e paregjistruara. Linja telefonike e Drejtorisë së Policisë së Shtetit ka marrë tri telefonata në lidhje me trafikimin, të cilat iu janë referuar autoriteteve përkatëse. Qeveria nuk ka ndërmarrë hapa për të ulur kërkesën për prostitucion apo për punë të detyruar.

## **PROFILI I TRAFIKIMIT**

Siç është raportuar gjatë pesë viteve të fundit, trafikantët e qenieve njerëzore shfrytëzojnë viktimat vendase dhe të huaja në Shqipëri, e trafikantët shfrytëzojnë viktimat nga Shqipëria jashtë vendit. Femrat dhe fëmijët shqiptarë i nënshtrohen trafikimit seksual dhe punës së detyruar brenda vendit, sidomos gjatë sezonit turistik. Trafikantët përdorin premtime të rreme të tilla si oferta për martesë apo punësim, për t'i detyruar viktimat të përfshihen në trafikimin seksual. Fëmijët shpesh detyrohen të lypin ose të kryejnë të tjera forma punësh të detyruara, si shitje e artikujve të vegjël. Fëmijët shqiptarë, kryesisht nga komunitetet rome dhe egjiptiane, shfrytëzohen në rajon për punë sezonale dhe lypje të detyruar. Pati edhe raste të punës së detyruar të fëmijëve në fusha kanabisi në Shqipëri dhe disa trafikantë me gjasë janë të përfshirë në trafik droge. Viktimat shqiptare i

nënshtrohen trafikimit seksual kudo në Evropë, sidomos në Kosovë, Greqi, Itali, Belgjikë, Gjermani, Zvicër, Maqedoni e Veriut, Norvegji, Holandë dhe Mbretërinë e Bashkuar. OJF-të raportojnë një rritje të numrit të fëmijëve shqiptarë të nënshtuar në punë të detyruar në Kosovë dhe në Britaninë e Madhe. Migrantët shqiptarë që kërkojnë punësim në Evropën Perëndimore përballen me punë të detyruar dhe me kriminalitet të detyruar. Viktimat e huaja nga vendet evropiane dhe Filipinet iu nënshtuan trafikimit seksual dhe punës së detyruar në Shqipëri. Migrantët e parregullt nga Azia punësohen gjithnjë e më shumë si punëtorë shtëpie nga familje të pasura, ku janë të prekshëm nga kushtet e skllavërisë në familje. Migrantët nga Lindja e Mesme, Azia Qendrore dhe Afrika kalojnë tranzit në Shqipëri për të arritur në Evropën Perëndimore dhe janë të prekshëm nga trafikimi.

###